



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

| | | |
|----------------------|--|-------------------------------------|
| Për : | Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Kristina Gashi Bytyçi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Ferizajt | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimera, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Besim Myrzani, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 04/09 /2019 Nr. 020-932 |
| Zyrtarët përgjegjës: | Xhevati Tafa, Udhëheqës i Divisionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Ferizajt | |
| Lloji i aktit: | Rregullore | |

I/ e nderuar Kryetar,
I/ e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore nr.94 për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre të komunës se Ferizajt

I miratuar më datë: 30.08.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.09.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike, ndërsa për pjesën e dispozitave ndëshkuese përkatësisht neni 31 është dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministrin e Financave. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

| | | |
|----------------------|---|---|
| Za: | Agim Aliu, gradonačelnik Opštine Uroševac Kristina Gashi Bytyqi, predsedavajuća Skupštine opštine Uroševac | |
| Cc: | Jedinici za administriranje sa dokumentima u MALS-u Jedinici za administriranje sa dokumentima u opštini | |
| Preko: | Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a | |
| Od: | Besim Myrtezani, v.d rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS | Datum, 04.09.2019. 020-932 |
| Odgovorni službenik: | 1. Službenik koji potvrđuje zakonsku procenu 2. Službenik koji izrađuje zakonsku procenu | Xhevati Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Uroševac | |
| Vrsta akta: | <input type="checkbox"/> Pravilnik Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelnike,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akata opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Pravilnik br.94 za groblja, pružanje pogrebnih usluga, uređivanje i njihovo održavanje u opštini Uroševac |
| Usvojena dana, 30.08.2019. godine |
| Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 03.09.2019.godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja opštinskog akta kao gore, smatra da je u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva i kao takav može da proizvede pravni efekat, budući da je za deo kaznenih odredbi člana 31. upućen ministarstvu finansija radi procene zakonitosti.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

3.09.2019

RREGULLORE

— VI - 010-935

PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE

FERIZAJ, 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



RREGULLORE

**PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE**

FERIZAJ, 2019

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12. paragrafi, 12.2, pika e) të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) i është neni 51 parafti 2 dhe pika 2.9 e Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr 50 të d.d. 28.06.2013, propozoi:

RREGULLORE

PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1. Qëllimi

- Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave;
- Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit publik.

Neni 2 Përkufizimet

- Me këtë rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - “**Vend-varrezë**” nënkuptojmë varrin dhe varrezat familjare;
 - “**Varr**” nënkuptojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomëri) ose mbetjet mortore;
 - “**Varrezë**” nënkuptojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjeter përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese e parkimit dhe e shërbimeve tjera);
 - “**Varmiliës**” nënkuptojnë punëtorin që hap varre në varrezat;
 - “**Varrim**” nënkuptojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr;
 - “**Varrhumbur**” nënkuptojmë humbjen e varrit, që nuk dihet se ku është varrosur;
 - “**Kufomë**” është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore ;
 - “**Shërbim i varrimit**” është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufonës;

- 1.9. "Zhvarrim" është nxjerja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri;
- 1.10. "Zhvarrim i zakonshëm" është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes;
- 1.11. "DSHP" eshte Drejtoria e Sherbimeve Publike;
- 1.12. "MAPL" është Ministria e Administrimit të Pushterit Lokal;
- 1.13. "Ekshumimi" -zhvarrosje, nxjerja e kufomës nga varri;
- 1.14. "Zhvarrim i jashtëzakonshëm" është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsyen transferimi në një varr tjeter, pas një periudhe të paracaktuar kobe ose për interes publik;
- 1.15. "Kohë e prehjes" është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

Neni 3 Varrezat

1. Në aspektin e hapësirës dallojmë këto varreza:
 - 1.1. varreza të vogla (deri në 5 ha);
 - 1.2. varreza të mesme (prej 5 deri në 20ha) dhe
 - 1.3. varreza të mëdha (mbi 20 ha);
2. Hapësira e përçaktuar për varreza duhet të jetë e paraparë me planin zhvillimor të komunes ose me plan të veçantë në pajtim me planin zhvillimor të komunës;
3. Varrezat duhet t'i përbushin nevojat për varrojen e të vdekurve në një vendbanim (fshat), disa vendbanime dhe brenda lagjeve lokale në qytet.

Neni 4

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe shifritëzimi e zgjerimi i varrezave ekzistuese duhet të bëhen me plan dhe të përcillen me projekt detali;
2. Plani përfshinë periudhën se paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në etapa;
3. Varrezat ekzistuese mund të zgjerohen, nëse për to ekziston hapësira e mjaftueshme dhe e përshtatshme dhe nëse janë të siguruara edhe kushtet tjera të parapara me këtë rregulllore dhe me ligjet në fuqi.
4. Ne varret ekzistuese, komuna obigohet ne afat sa shkurtër te beje plane detale të varrezave.

Neni 5

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) dhe të veçanta;
2. Në varreza të veçanta hyjnë: varret me përmendore, varret ushtarake, varret e heronjve dhe dëshmorëve, varret anonime, varret masovike prej fatkeqësive natyrore dhe varret sipas përkatesisë fetare, e të ngashme.

Neni 6

1. Sipërfaqja e nevojshme neto për varri duhet të jetë 2.00 metra katrore për banor;
2. Te përeaktimi i sipërfaqes për varri, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit;
3. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën vendin e varrit;
4. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshin neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

Neni 7

1. Varrezat duhet vodosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, i përshtatshëm sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje;
2. Vendi i varrezave duhet të jenë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit me qasje në rrugë dykratëshe dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë;
3. Hapësira për varreza duhet t'i përbush këto kriterë:
 - 3.1 Sipas pozitës së varrezave toka duhet të jetë e kulluar, me reze dhe e qetë të jenë larg rrjedhavje nëntokësore dhe sipërfraqësore të ujërave, jashtë zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërvshohen nga ujërat, zonave të mbrojtura natyrore dhe rajoneve malore;
 - 3.2 Varrezat e reja duhet të jenë së paku 50 m nga rruga automobilistike, respektivisht qendra të ndërtuara ose që do të ndërtohen, ndërtesa të dedikuara për çështje afariste;
 - 3.3 Tek zgjerimi i varrezave ekzistuese, largësia duke pasur parasysh pikën 3 të nenit 7, mund të jetë deri në 10 m, me kusht që për gjatë varrezave të sigurohet një shirit gjelbëruesh në gjerësi minimale prej 5 m i cili e përshton tërë gjatësinë e objekteve kontaktuese.

Neni 8

1. Varrezat përbëhen prej:

- 1.1 Vendit të varrit (vetë varri);
- 1.2 Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret);
- 1.3 Fushat e varrezave (disa rende të varreve por jo më tepër se 200 varre në një shteg);
- 1.4 Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve;
- 1.5 Shtigjet kryesore të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën përzgjerim;
- 1.6 Rrugëve interne dhe eksterne (jashtne) për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin;
- 1.7 Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse);
- 1.8 Vendi ku bëhet përshtendetja e fundit lartumirës, mund të jetë i myllur ose i hapur në përpunje me rregullat sipas përkatësisë fetare;
- 1.9 Objektet tjera përcjellëse shërbysese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare);
- 1.10 Parkingu për automjete;

Neni 9

1. Varri është gropë e varrit me proporcion sipas normave urbanistike:

- 1.1. 1.00 x 0.60 m - deri në moshën 3 vjet;
- 1.2. 1.50 x 0.60 m – 1.50 x 0.75 m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet;
- 1.3. 2.10 x 0.70 m – 2.50 x 1.20 m mbi 11 vjet;
- 1.4. 2.20 x 0.90 m (vendvarri me dominuese).

2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përrektuara në paragrafin 9.1 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore;
3. Thellësia e varrit përrektohet në bazë të rregullave sipas riteve fëtare, e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm;
4. Dimensionet e varrezave familjare janë 2.40 x 2.80 m, maksimalisht 4 varreza:
(Varrezat familjare, mund te lejohen me vendim te vecant te Kuvendit Komunal, ku caktohet edhe numri i kufizuar i rezervimeve si dhe taksa per rezervim);
5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas riteve fëtare, por jo më shumë se 0.80 m;
6. Distanca ne mes te dy varreve nuk mund te jetë me e vogel se 60 cm;
7. Distanca ne mes te dy varreve nuk mund te jetë me e vogel se 80 cm (pjesa ndërmjet rendeve te vendvarrimit).

Neni 10

Projektet për varrezat e reja si dhe për ato ekzistueset duhet të përmubajnë edhe këto detaile:

1. Guri i cili do të vëndoset mbi nivelizues (afër varri), duhet të ketë keto dimensione te të gjitha vendvarrimet
 - Gjerësia – 60 cm maksimale
 - Gjatesia – 60 cm maksimale
 - Guri horizontal i shtrire mbi nivelizues – 90 cm x 30 cm
2. Të gjitha vendvarrimet duhet të janë të piketurat.
3. Distancat në mes të vendvarrimit duhet të janë të njëjtë dhe nuk mund të ndryshojnë, ashtu siç parashihen në projektin e hollësishëm.
4. Të gjitha vendvarrimet (bloqet ose njesite) do të kenë një shenjë, numër, psh. A1, A2, B3, C3, D4 etj. varësisht nga organizimi i prezantuar ne planin e hollësishëm i cili shënim do të shënohet edhe në çertifikatën e vdekjes
5. Projekti (legjenda) duhet të jetë i vendlorur në fillim me një pllakë të veçantë informuese.
6. Format e drejtë paralele të vendvarimeve do të janë kryesore në gjithë projektin, nuk do të lejohen të tejkalojen matjet gjecodzike.
7. Varret duhet të janë të rrashtha dhe të gjelbërnara
8. Duhet të parashihet - sigurohet hapësira për vendëpunishte
9. Varrezat duhet të janë të renditura në atë mënyrë që rendet e varrezave të mos të janë më të gjata se 60 m;
10. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për me shkuar deri te vari;
11. Fushat e varrezave duhet të janë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m;

12. Shtigjet duhet të jenë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1%.

Neni 11

Me rastin e varrosjes, duhet të mbahet evidenca nga ana e organit kompetent (DSHP) respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrjes tjeter e specializuar për këtë çështje të autorizuar dhe shënimet e këtyre evidencave dorëzohen zyrtarisht në administratën e komunës për t'i evidentuar në çertifikatat e vdekjes si adresa të varreve.

Neni 12

1. Në pajtim me nenin 8 pika (9) të kësaj rregulloreje, objektet tjera përcjellëse shërbysese hapësitën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare), mund të jetë: me thupra metalike me bazament osc material (jetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave;
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar duke pasur parasysh rregullat e riteve fetare të komuniteteve;
3. Parku i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike;
4. Rrugët e këmbësorëve - shtigjet rregullohen si trotuare të pavurura për qasje deri te vend vtrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep);

Neni 13 Mirëmbajtja e varrezave

1. Komuna duhet ta caktojë ndonjë kompani publike apo private e cila do të administrojë me punët e varrimit, të rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave në qytet dhe në të gjitha fshatrat, konform ligjeve ne fuqi.
2. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me pietet dhe dinjitet nga komuna, duke respektuar të gjitha konfesionet fetare;
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtijen nen, të gjithë qytatarët e komunës së Ferizajt pavarësisht përkatesisë fetare do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale sipas kushteve të parapara me Ligj dhe me këtë Rregullore.
4. Komuna mund të sigurojë edhe shërbimin e fundit për të vdekurit nga Bashkësítë fetare përkatese

Neni 14

Punët e varrimit, të rregullimit dhe të mirëmbajtjes së varrezave në territorin e Komunës i kryen ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjeter e specializuar për këtë qëllim.

Neni 15

1. Punët në vështrim të nenit 14 të kësaj rregulloreje rregullohen me kontratë administrative në pajtim me rregullat për prokurimin publik dhe shërbimeve publike;
2. Rregullimi i varrit (vendosjen e pllakës, gurit me mbishikrim) e bëjne anetaret e familjes se te vdekurit, nen mbikqyrjen e kompanise që administrojn me varrezat, konform nenit 14.

Neni 16

1. Mirëmbajtja e varrezave, në vështrim të kësaj rregulloreje përfshinë: objektet tjera përcjellëse shërbyese (hapësira për qëndrim të kufomës), ndriçimin publik, rrugët kalimtare, shtigjet, kroin për ujc, rrethojën e varrezave, parkan e automjeteve, stabilimentet sanitare, gjelbërimin, prerja e barit me se paku 4 here ne vjet, pastertinë dhe rendin në varreza;
2. Mirëmbajtja (disa punë zejtare) në varr dhe varrezi familjare mund të bëhen nga ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë çështje, përashtimisht edhe nga vetë familjarët e të vdekurit në këto kushte:
 - 2.1. Të merret leja nga ana organit kompetent (DSHP) ose ndërmarrja publike e autorizuar;
 - 2.2. Koha e kryerjes së punëve duhet të jetë prej orës 07:00 - 18:00 në ditët e ponës;
 - 2.3. Materiali ndërtimor (rëra, zhavorri, hekuri dhe materiali tjetër) lejohet të qëndrojë në varreza për kohë të shkurtër në mënyrë që të mos pengoi lëvizjen e vizitorëve në varreza dhe pas kryerjes së punëve duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme, (përveç nëse është e caktuar edhe hapsira e veçantë përvendpunishtë sipas nenit 10 pikë 8)
 - 2.4. Transporti i materialit, duhet të bëhet vetëm nëpër rrugë dhe shtigje që i caktuan dhënësi i lejes;
 - 2.5. Gjatë punimeve nëse haset në ndonjë pjesë të arkivolit ose ndonjë asht (kokë) duhet të mbulohen në të njëjtin vend;
 - 2.6. Nëse gjatë punimeve gjinden sende me vlerë duhen t'i dorëzohen Organit kompetent;
 - 2.7. Kroj, gjatë përdorimit duhet të përdoret me kujdes që mos t'ju shikaktohet dëmi varreve dhe varrezave tjera dhe;
 - 2.8. Për vendosjen e pllakave përkujtimore ose përmendoreve, duhet të paraqitet kërkesë e veçantë me skicën e objektit, respektivisht përmendores dhe vërtetimin se është siguruar shifrlëzimi i vendvarrimit.
3. Shpenzimet lidhur me kryerjen e punëve sipas paragrafit 2 të këtij neni bien në barrë të atij i cili bënë kërkesën përmirësim të varrit dhe varrezave familjare.

Neni 17

1. Planin e mirëmbajtjes së varrezave, kushtet dhe tarifat i caktuan DSHP-ja;
2. Tarifat për shërbimet e varrimit dhe lidhur me varrezat përcaktuhen me rregullore përtaksë, tarifa dhe gjoba me propozim të DSHP-së (nëse këto shpenzime nuk i mbulon komuna)

Neni 18 Sjellja në varreza

1. Vizitudesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen në mënyrën e cila i përgjigjet peticionit ndaj të vdekurve dhe me dënjët në vendet ku ato prehen:

- Varrezat nuk mund të vizitohen në çdo kohë përpos në kohën në të cilën lejohet vizita e varrezave e publikuar nga ana e organit kompetent në hyrje të varrezave;
- Në varreza nuk mund të sillen fëmijët deri në moshën 10 vjeçare. Përjashtimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

Neni 19

1. Në varreza ndalohet:

- Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve ;
- Shkelja dhe kapercimi nëpër varre dhe varreza dhe shlyerja tyre;
- Shkaktimi dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objektive tjera përkujtimore në varreza);
- Prishja e rendit në varreza;
- Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjtëve dhe bimëve tjera të mbjellura në varreza;
- Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete private dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak;
- Futja e kafshëve;
- Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vendosja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera ;
- Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale dhe shpërndarja e fletëpalosjeve;
- Sjellja dhe lënia pa leje e sendeve të ndryshme në varre dhe varreza që nuk kanë të bëjnë me varre dhe varreza;
- Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektit tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim, përjashtuar rastet me autorizim të veçantë;
- Qëndrimi i lysarëve brenda dhe në hyrje të varrezave;
- Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave;
- Ushtrimi i çdo illoj tregtie.
- Pjesëmarria në zhvarrimin e kufomave që nuk i përkasin familjes, përveç rasteve kur ka pëlqimin e palëve, që kanë të drejtë sipas autorizimit të veçantë .

Neni 20

DSHP-ja cakton rregullat e sjelljes në pajtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje dhe duhet publikuar në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

Neni 21 Varrimi dhe veprimet tjera lidhur me varrimin

- Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare edhe sipas mënyrës që i përgjigjet pietitetit ndaj të vdekurit, në saje të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin;
- Me procesin e varrimit nënkuptojmë vendosjen në tokë dhe mbulimi me dhë i trupit të personit të vdekur në thellësi të caktuar në lokacionin e varrezave.

Vendosjen në tokë dhe mbulimi me dhë i urmës së hirit të kufomës së djegur.

Vendosjes në tokë dhe mbulimit të eshtrave të personave të vdekur më parë.

Vendosjes në tokë dhe mbulimit me dhë të placentave

3. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi i ë jetë vërtetuar vdekja në mënyrë të caktuar me dispozita të veçanta
4. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet pasi që të kalojnë 12 orë pas vdekjes, përpos rasteve kur mjeku i autorizuar e jep mendimin se mund të bëhet varrimi i të vdekurit edhe para skadimit të këtij afati.
5. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjallti, ose në varrezat që i zgjedhë familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij.

Neni 22

Lejen për varrimin e të vdekurit në varrezat e caktuara dhe lejen për vendvarrim në qytet dhe fshat e jep DSHP-ja, respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjeter e specializuar e autorizuar, si dhe në koordinim me zyrën e gjendjes civile në Komunë,

Neni 23

1. **Bartja e kufomave bëhet me arkë për kufoma (arkivol) apo tabut;**
2. Deri në aktin e varrosjes kufomat duhet të ruhen në lokale të caktuara për këtë qëllim;
3. Bartja e kufomave deri te varrezat bëhet sipas rregullave të riteve fetare të komuniteteve apo pereaktimin e familje
- 4.

Neni 24

Bartjen e kufomave në territorin e komunës mund ta bëjë ndërmarrja publike e specializuar komunale ose ndërmarrja tjeter e specializuar e kontraktuar për këtë qëllim apo nga ana e vetë familjarëve.

Neni 25

Para varrimit, kufomat e personave të merituar, heronjve dhe dëshmorëve dhe personave tjera me meritë të veçanta, mund të ekspozohet në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënies së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i vdekjes bëhet nga organet komunale ose organet qendrore të shtetit.

Neni 26

1. Nëse veprintaria e varrimit organizohet nga ndërmarrja publike lokale ose ndërmarrja tjeter publike e specializuar, është e detyruar që për varrimin e të vdekurve të sigurojë shërbimin e përditshëm, duke përfshirë edhe të dielat dhe festat shtetërore sic vijon:
 - 1.1. Prej 1 majit deri me 30 shtator prej orës 08:00 deri në orën 18:00;
 - 1.2. Prej 1 tetorit deri më 30 prill prej orës 08:00 deri në ora 16:00.
2. Veprintaria e varrimit sipas paragrafit i të këtij nenit, regullohet me anë të kontratës në mes të DSHP-së dhe ndërmarrjes publike lokale të specializuar ose ndërmarrjes tjeter të specializuar për këtë qëllim.

Neni 27

Komuna e Ferizajt me ketë rregullore obligohet që brenda mundësive dhe kapacitetit buxhetor t'i mbuloj finansiarisht shërbimet e varrimit dhe të transportit për të gjithë qytatarët e Komunës.

Neni 28

Dhënia e nderimit të fundit të (të pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përaktuar në vend-varreza.

Neni 29

1. Me pëlqimin e organit kompetent komunal dhe inspeksionit sanitari në prani të policisë së Kosovës, mund të bëhet zhvarrosja (nxjerja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur – rivarosur në një vend-varrezë tjeter ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave);
2. Lidhur me pikën 1 të këtij nenit mbahet procesverbalia nga ana e organit kompetent ose personit tjeter të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët;
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionia e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin).

Neni 30 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyjen në zbatimin e dispozitiveve të kësaj rregulloreje e bënë organi kompetent për çështje të shërbimeve komunale (DSHP-ja) si dhe inspeksioni sanitari (përkatësi);
2. Inspeksioni sanitari gjatë mbikëqyrjes mund të merr masa dhe të urdhërojë marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit;
3. Në vendimin e inspeksionit mund të ushtrohet ankesa në afatin prej 30 ditësh nga ditë e njoftimit, drejtuar Kryetarit të Komunës.

Dispozitat ndëshkimore

Neni 31

1. Për shkelje të nenit 16 paragrafi 2, nenit 19 paragrafi 1 nëmparagratët 1 – 16 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 1.1. Për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nëshumën prej 10 € - 100 €;
 - 1.2. Për personin fizik që ushton biznes individual prej 30 € - 250 €;
 - 1.3. Për personin juridik prej 100 € - 1,500 €.
2. Për shkelje të nenit 10 paragrafi 2,3,4 dhe 5 dënohen përkundërvajtje me gjobë:
 - 2.1. Për personin fizik që ushton biznes individual prej 30 € - 250 €,
 - 2.2. Për personin përgjegjës të personit juridik, 10 € - 100 € dhe
 - 2.3. Për personin juridik, dënohet 100 € - 1,500 €.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimitare

Neni 32.

1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozitat ligjore.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për varrezat, mirembajtjen e tyre dhe varrimin e vitit 2007.

Neni 33

Kjo rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Ferizajt

_____, dt. _____
01.nr. _____

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Kristina Gashi Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

| | |
|----------------|--|
| Për: | Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm në MF |
| Kopje: | Agim Aliu, Kryetari i komunës së Ferizaj Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL |
| Përmes: | Rozafa Ukimieraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL |
| Nga: | Besim Myretzani, u.d i DILMK-së |
| Lënda: | Shqyrtimi i ligjshmërisë |
| Lloji i aktit: | <input type="checkbox"/> Rregullore komunale |

Datë: 03/09/2019
Nr. 020/935

Inderuar Sekretar.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregulloren nr. 94 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizaj, dhe i nënshkruar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Ferizaj, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm/rregullt të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 031-05 Për Veteqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Rregullore nr.94 për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre përkatesisht nenin 31 "dispozitave ndëshkuese"

I miratuar më datë: 30.08.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.09.2019